

DIPLOTALKS



DIPLO TALKS

Shkurt 2026

Mirësevini në DIPLO-TALKS

DIPLO-TALKS është buletini mujor që sjell në vëmendje zërin, vizionin dhe veprimin e diplomacisë shqiptare në arenën ndërkombëtare. Ai pasqyron arritjet kryesore të përfaqësive tona diplomatike dhe konsullore, si edhe zhvillimet më të rëndësishme të politikës së jashtme, në shërbim të interesave strategjike të Shqipërisë.

Në çdo edicion, DIPLO-TALKS përmbledh ngjarjet më domethënëse të muajit, aktivitetet kyçe të procesit të integrimit evropian, diplomacinë ekonomike dhe kulturore, angazhimin me diasporën, si dhe iniciativa që forcojnë imazhin dhe rolin e Shqipërisë si një aktor i besueshëm dhe konstruktiv në marrëdhëniet ndërkombëtare. Përmes shembujve konkretë suksesi, buletini synon të evidentojë punën e përditshme të diplomacisë sonë dhe ndikimin real të saj në promovimin e paqes, zhvillimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.



DIASPORA



SAMITI IV
DIASPORËS



AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS

Albanian Diaspora Summit 2030 Through Roots We Rise

SAVE THE DATE
14-15 APRIL 2026
Tirana, Albania



Njoftim për t'u shpërndarë!

Diaspora rikthehet në shtëpi!

Bashkohuni në një hapësirë unike dialogu dhe bashkëpunimi, ku shqiptarët nga e gjithë bota lidhen me institucionet dhe komunitetet në Shqipëri. Ky samit ofron mundësinë për të ndarë ide, përvoja dhe projekte, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin e vendit tonë dhe në vizionin për Shqipërinë 2030. Mos e humbisni këtë mundësi për të qenë pjesë e ndryshimit dhe të ardhmes së përbashkët!

[Link për regjistrimin e pjesëmarrësve!](#)

DISKUTIM I HAPUR

Mbi përgatitjen e
Strategjisë Kombëtare
të Diasporës
2026-2030



27.02.2026
ORA 11:00

KUBI BLU, PIRAMIDA

Diskutim i hapur për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2026–2030

Në ambientet e Piramidës u zhvillua një diskutim i hapur në kuadër të hartimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2026–2030, me pjesëmarrjen e znj. Miriam Shyti, Zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, përfaqësuesve të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, ekspertëve të IOM-it, anëtarëve të GNIP dhe aktorëve të tjerë institucionalë.

Takimi shërbeu si një platformë bashkëpunimi për ndarjen e ideve, sugjerimeve dhe propozimeve konkrete, duke u fokusuar në qasjen metodologjike të strategjisë, prioritetet sektoriale dhe ecurinë e procesit konsultativ.



NGJARJET KRYESORE

1. [Ministeriali i Tiranës për Korridorin VIII, Spiropali: Aset strategjik për ndërlidhjen dhe sigurinë europiane, Shqipëria një nga nyjet më të besueshme të këtij projekti](#)
2. [Spiropali në Konferencën e Sigurisë të Mynihut: Shqipëria vijon kontributin për forcimin e partneritetit transatlantik, teksa ecën përpara drejt BE](#)
3. [Spiropali takim me Kurtin, Osmanin, Haxhiun dhe Konjufcën: Shqipëria dhe Kosova bashkë me vizion afatgjatë](#)

INTEGRIMI NË BE



Eksperienca çeke si udhërrëfyes për Shqipërinë drejt BE-së


Më 5 shkurt 2026, Ambasadori Ilir Tepelena zhvilloi një bisedë të hapur dhe miqësore me Pavel Telička, ish-Kryenegociator i Çekisë në procesin e aderimit në BE dhe ish-Zëvendës President i Komisionit Evropian. Në fokus të diskutimit ishte përvoja çeke mbi sfidat, vendimet kyçe dhe mësimet e nxjerra gjatë negociatave të anëtarësimit, të cilat mbeten aktuale dhe frymëzuese për rrugëtimin e Shqipërisë drejt Bashkimi Evropian. Z. Telička shprehu gatishmërinë për të ndarë eksperiencën e tij institucionale dhe njerëzore me institucionet shqiptare, në mbështetje të procesit të integrimit evropian.

Ballkani Perëndimor drejt transparencës dhe efektivitetit në ndihmën shtetërore

Në bashkëpunim me Institutin për Kërkime Ekonomike dhe Politika Financiare dhe Finance Think dhe me ftesë të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Shkup, u organizua një panel diskutimi në Shkup që mbledhi përfaqësues të akademisë, biznesit, institucioneve rajonale dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Fokus i diskutimit ishte forcimi i politikave të rialokimit të fondeve dhe subvencioneve publike në Ballkanin Perëndimor, duke respektuar kriteret e transparencës, efektivitetit dhe përputhshmërisë me direktivat e Bashkimit Evropian. Në këtë kuadër, znj. Blagica Petreski, nga Finance Think, prezantoi analizën e saj mbi sfidat dhe rolin e ndihmës shtetërore në zhvillimin ekonomik dhe integrimin evropian, duke hapur rrugën për politika më të qëndrueshme dhe bashkëpunim rajonal efektiv.





Shqipëria forcon partneritetin me OBSH-në: Marrëveshje dyvjeçare për një sistem shëndetësor modern

Në Kopenhagë, më 20 shkurt 2026, u zhvillua vizita zyrtare e Ministres së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Evis Sala, në Zyrën Evropiane të Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). Gjatë takimeve, Ministria Sala prezantoi vizionin e qeverisë shqiptare për ndërtimin e një sistemi shëndetësor modern, të qëndrueshëm dhe plotësisht të harmonizuar me standardet europiane, duke theksuar rëndësinë e reformave strukturore dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

Në kuadër të kësaj vizite u firmos edhe marrëveshja dyvjeçare e bashkëpunimit me OBSH-në, e cila synon të mbështesë Shqipërinë në garantimin e aksesit universal në kujdes shëndetësor cilësor. Marrëveshja parashikon asistencë teknike, forcim të kapaciteteve institucionale dhe mbështetje në zbatimin e politikave që sigurojnë barazi dhe qëndrueshmëri në sistemin shëndetësor, duke e afruar vendin edhe më shumë me praktikat më të mira europiane.

DIPLOMACIA EKONOMIKE



Korridori VIII drejt Prioritetit Evropian: Forumi Ekonomik thekson rolin strategjik të Shqipërisë në ndërlidhjen rajonale dhe rritjen ekonomike

Në kuadër të Ministerialit të Korridorit VIII, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme organizoi Forumin Ekonomik me temë “Ndërlidhja Strategjike dhe Rritja Ekonomike Rajonale: Potenciali Ekonomik i Korridorit VIII”, me fokus konkretizimin e rolit të tij strategjik për rajonin dhe Evropën.

Diskutimet theksuan Korridorin VIII si një instrument kyç për integrimin evropian, zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin rajonal, duke nënvizuar nevojën për integrim të plotë në rrjetet TEN-T, përsheptim të financimit dhe zbatim të projekteve prioritare. U evidentua roli i Shqipërisë si nje lindje-perëndim dhe portë e Adriatikut, si dhe rëndësia e infrastrukturës multimodale, sigurisë së infrastrukturës kritike dhe koordinimit rajonal për ta zhvilluar korridorin si një platformë të qëndrueshme rritjeje dhe bashkëpunimi afatgjatë.


Korridori 8 hyn në infrastrukturën ushtarake të NATO-s, Shqipëria në qendër të arkitekturës së sigurisë

Më 12 shkurt 2026, në selinë e NATO në Bruksel, gjatë takimit të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare, ku mori pjesë edhe ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Pirro Vengu, u konfirmua përfshirja zyrtare e Korridorit 8 – me pikënisje nga kompleksi portual Porti i Durrësit - Porto Romano dhe dalje në Detin e Zi – në planet e infrastrukturës kritike ushtarake të Aleancës. Ky vendim e pozicionon Shqipërinë si një strategjike në mbrojtjen kolektive euroatlantike dhe në planet rajonale të viteve në vijim. Ministri Vengu e cilësoi zhvillimin si rezultat të një pune disa vjeçare të qëndrueshme, ndërsa theksoi edhe angazhimin për rritjen e investimeve në mbrojtje dhe fuqizimin e industrisë ushtarake vendase. Paralelisht, kanë nisur përgatitjet për Samitin e NATO-s që do të mbahet në Tiranë në vitin 2027.



“Invest në Shqipëri”: Hapësira për partneritete të reja biznesi


Ambasadorja Milo zhvilloi një takim me z. Ivan Anchev, drejtues i Dhoma e Biznesit Bullgaro-Shqiptar, ku u diskutuan hapat pas iniciativës së mëparshme “Invest në Shqipëri”, organizuar nga Ambasada e Shqipërisë në Sofje. Takimi shërbeu për të eksploruar mundësi të reja bashkëpunimi dhe për të forcuar partneritetet ekonomike midis dy vendeve, me një fokus të veçantë tek pjesëmarrja e bizneseve bullgare në Forumit Ekonomik të Korridorit VIII në Tiranë më 18 shkurt, një platformë kyçe për të nxitur lidhshmërinë, tregtinë dhe rritjen ekonomike rajonale.



Shqipëri–Japoni: Mundësi të reja investimi dhe partneritete inovative

Më 20 shkurt, Ambasada e Shqipërisë në Tokio organizoi me sukses Forumin e Biznesit Japoni–Shqipëri në ambientet e Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JBIC). Ngjarja bashkoi liderë institucionalë dhe biznesmenë nga të dy vendet, duke krijuar një platformë të fuqishme për të eksploruar mundësi investimi dhe partneritete strategjike.

Delegacioni shqiptar, përbërë nga Zv/Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit Enkelejd Musabelliu, Zv/Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë Erlind Sulo, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s Laura Saro dhe CEO i Autoritetit Portual Durrës Liburn Aliu, prezantoi potencialin e Shqipërisë si destinacion investimi dhe mundësitë konkrete për projekte inovative. Ngjarja u hap nga Presidenti i Institutit Japonez për Investime Jashtë (JOI), Kenichiro Hayashi, ndërsa Ambasadori



Ermal Muça nënvizoi progresin e Shqipërisë drejt BE-së dhe sigurinë e vendit për investime të qëndrueshme. Sesionet B2B ofruan mundësi konkrete për lidhje dhe bashkëpunime që do të forcojnë marrëdhëniet ekonomike Shqipëri–Japoni në vitet në vijim.



Biznesi slovack drejt Tiranës: Forum tre-ditor për partneritete të reja ekonomike

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Slloake ka njoftuar në faqen e saj zyrtare organizimin e një udhëtimi biznesi në Tiranë, në datat 11–13 maj 2026, me fokus pjesëmarrjen në Forumin e Biznesit sllovak-shqiptar që do të zhvillohet në Hotel Grand Tirana. Sipas njoftimit, kompanitë slloake do të kenë mundësinë të prezantojnë produktet dhe shërbimet e tyre, të zhvillojnë takime B2B, të krijojnë kontakte të reja dhe të forcojnë bashkëpunimin me partnerë shqiptarë. Programi tre-ditor përfshin darkë mirëseardhjeje me përfaqësues të Ambasadës, pjesëmarrje në forum me prezantime dhe drekë pune, si dhe negociata individuale me kompani dhe institucione shqiptare, duke synuar thellimin e marrëdhënieve ekonomike mes dy vendeve.

Shqipëria në Teknologji Globale: Takim me Commercey

Më 10 shkurt, i Ngarkuari me Punë, Eno Çollaku, zhvilloi një takim me kompaninë shqiptare Commercey për të diskutuar projektet e tyre ndërkombëtare dhe pjesëmarrjen në Techarena, forumin e zhvilluar më 11–12 shkurt në Stokholm, ku Commercey prezantoi inovacionet e saj dhe shfaqti potencialin e teknologjisë shqiptare në arenën globale.



Historia e parë në fluturimet Shqipëri–Kanada

Më 20 shkurt 2026, Ambasadorja Artemis Malo organizoi një ceremoni të veçantë me ekipin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kanadasë për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit në Transportin Ajror ndërmjet Shqipërisë dhe Kanadasë, një hap historik për lidhjet dypalëshe.

Ceremonia u zhvillua në një atmosferë konstruktive, ku u theksua gatishmëria për thellimin e bashkëpunimit, ndërsa Z. Howard Liebman, Zëvendësprezident i Air Transat, përfaqësoi interesin konkret të sektorit privat. Momenti u shënuar edhe me prezantimin simbolik të miniaturës së Airbus A330 që do të operojë fluturimin e parë historik mes dy vendeve.



Shqipëria dhe Polonia nënshkruajnë Marrëveshjen për Sigurimet Shoqërore në Varshavë

Në Varshavë u firmos Marrëveshja për Sigurimet Shoqërore mes Republika e Shqipërisë dhe Republika e Polonisë, një zhvillim i rëndësishëm që rrit sigurinë dhe garancitë për qytetarët që jetojnë e punojnë mes dy vendeve.

Kjo marrëveshje mundëson njohjen dhe bashkimin e viteve të sigurimit, garanton të drejtën për pension sipas legjislacionit në fuqi dhe mbron përfitimet e çdo qytetari që ka kontribuar në të dy shtetet.

Me këtë nënshkrim, Shqipëria shënon marrëveshjen e 11-të me vende të Bashkimit Europian për njohjen e viteve të pensionit dhe të 17-ën në total, duke zgjeruar rrjetin e mbrojtjes sociale dhe duke afruar më tej standardet me ato europiane. Një tjetër hap konkret drejt forcimit të bashkëpunimit dypalësh dhe sigurisë sociale për qytetarët tanë.



DIPLOMACIA KULTURORE



Shqipëria në fokusin e turizmit global: Bashkëpunim me GTF dhe EUReflect

Më 11 shkurt 2026, Ambasadorja Albana Dautllari zhvilloi një takim me përfaqësues të Global Tourism Forum (GTF) dhe EUReflect, për të shqyrtuar mundësitë e bashkëpunimit në promovimin e turizmit shqiptar. Gjatë bisedës u prezantua GTF si një platformë ndërkombëtare e nivelit të lartë, organizuar në partneritet me Euronews, që nxit dialog mbi diplomacinë, gjeopolitikën dhe ekonominë globale të turizmit. Diskutimi përfshiu edhe mundësinë e pjesëmarrjes së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë në edicionin e ardhshëm të Forumit në Bruksel në tetor 2026, një shans i veçantë për të promovuar potencialin turistik të vendit tonë përpara një audience ndërkombëtare elitare.



Një urë dijeje mes Shqipërisë dhe Europës në Mynih

Gjatë vizitës në Mynih, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Elisa Spiropali, vizitoi Katedrën e Albanologjisë në Universitetin Ludwig-Maximilian të Mynihut, duke riafirmuar rolin e saj si një urë e qëndrueshme mes Shqipërisë dhe Europës. E pritur nga Prof. Dr. Carola Metzner-Nebelsick dhe Prof. Dr. Enkeleida Kapia, ministrja vlerësoi kontributin historik të kësaj katedre, të themeluar nga Martin Camaj, në forcimin e lidhjeve akademike, kulturore dhe politike. Ajo theksoi se Albanologjia në Mynih mbetet një pikë referimi për studimin e gjuhës, historisë dhe identitetit shqiptar në Europë, duke dëshmuar se rrugëtimi evropian i Shqipërisë mbështetet mbi themele të forta dijeje dhe kulture.



Shqipëri–Azerbajxhan: Ura e Kulturës dhe Letërsisë

Më 1–2 shkurt, Ambasadori Besart Kadia së bashku me Këshilltarin e Ambasadës, Dorian Koçi, vizituan Bibliotekën Kombëtare të Azerbajxhanit, ku u pritën nga Prof. Karim Tahirov dhe znj. Fidan Bayramova. Takimi u shndërrua në një dialog të pasur kulturor, duke celebruar bashkëpunimin mes dy vendeve përmes letërsisë dhe artit.

U riafirmua rëndësia e Memorandumit të Bashkëpunimit të vitit 2022, që ka sjellë Këndin e Letërsisë Shqiptare në Baku dhe Këndin e Letërsisë Azerbajxhanase në Tiranë, duke krijuar një urë të gjallë dijesh dhe emocioni mes dy traditave. Ambasadori Kadia theksoi angazhimin për të thelluar shkëmbimet kulturore, digjitalizimin e arkivave dhe organizimin e aktiviteteve kushtuar shkrimtarëve të mëdhenj shqiptarë, duke u bërë kështu një urë që lidh zemrat dhe mendjet përmes artit, kulturës dhe Ëalës së shkruar.

Ulqini dhe Tuzi promovojnë turizmin në “Albania 2026”

Falë përpjekjeve të lobimit nga Ambasadorja Peto, Kryetari i Komunës së Ulqinit, Genci Nimanbegu, mori pjesë në Panairin e Turizmit “Albania 2026” dhe zhvilloi një takim me Ministrin Blendi Gonxhja, duke diskutuar mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit turistik. Në të njëjtën kohë, Organizata Turistike e Komunës së Tuzit prezantoi ofertën e saj autentike në një stendë të veçantë, duke tërhequr vëmendjen e vizitorëve rajonalë dhe ndërkombëtarë, krijuar lidhje të reja bashkëpunimi dhe promovuar potencialin turistik unik të zonës.

